# DËSHMI ARKIVI

**A-470699**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Ndeshja me Bjellorusinë, policia tregon rrugët që bllokohen në Tiranë |
| ADRESA | `https://lapsi.al/ndeshja-me-bjellorusine-policia-tregon-rruget-qe-bllokohen-ne-tirane-i1094500` |
| BURIMI | lapsi.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 26 shtator 2026, 07:17:55 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 26 shtator 2026, 07:16:46 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `4e769027021c662d71e951efa8305f6825b3fa42ce41065a73f1236f33ca9c1f` |
| TEKSTI | `748aade35dbe7fe6925322252ca203c909c894165eaf3f0a051fa941009bf276` |
| PAMJA | `b946aae64a96521ee5839bd93931858defb3cedb59b4c44e584c94d080243c55` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `1f538ae8354169c3a40490d9ec5d807f6296dccc5f26954718e5f3f1f9d8d8d4` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `a38a4fa799b1e73bbabeaa0ef113694411dbd892b18eb619eb2f3db166512539` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/1f538ae8354169c3a40490d9ec5d807f6296dccc5f26954718e5f3f1f9d8d8d4`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Ndeshja me Bjellorusinë, policia tregon rrugët që bllokohen në Tiranë

LAPSI.AL • 26 SEPTEMBER 2026




Policia e Shtetit ka marrë masat për garantimin e rendit dhe sigurisë para, gjatë dhe pas ndeshjes mes Shqipërisë dhe Bjellorusisë, e cila do të zhvillohet mbrëmjen e sotme në stadiumin “Air Albania”, në orën 20:45.

Për shkak të fluksit të tifozëve, nga ora 17:00 deri në përfundim të ndeshjes do të ketë kufizime të qarkullimit të automjeteve në disa akse rrugore pranë stadiumit.

Rrugët që do të bllokohen janë:

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nga fast food-i “Laguna”, pranë urës së ish-Hotel Dajtit;

Rruga “Papa Gjon Pali II”, te kryqëzimi i RTSH-së;

Rruga “Dervish Hima”, pranë Ambasadës së SHBA-së;

Rruga “Asim Zeneli”, pranë Ambasadës së SHBA-së;

Rruga “Themistokli Gërmenji”, në hyrje;

Rruga “Ismail Qemali”, te kryqëzimi i RTSH-së;

Rruga “Lekë Dukagjini”, pranë ish-Gardës së Republikës, ku do të lejohet vetëm kalimi i mjeteve të autorizuara nga FSHF-ja;

Rruga “Abdyl Frashëri”, pranë kryqëzimit të Librit Universitar;

Te sheshi “Willson”, ku lëvizja do të devijohet në drejtim të rrugës “Sami Frashëri”, pak

ide


Gysi, Bela, Lali, Klodi si maska të një njeriu të vetëm
Andi Bushati


Rënia e Vlorës në shtratin e krimit
Armand Shkullaku

MOTI TIRANA 16°C
KËMBIMI EURO 91.97

aktuale

19:50
Rama jep mend në OKB për Inteligjencën Artificiale: Mund të fabrikojë realitetin sipas frikërave të qytetarëve

08:49

Rama në OKB, në fokus Bordi i Paqes dhe çështja e ish-krerëve të UÇK-së



TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndiqe Lapsin edhe në

Me interes nga publiku



Te sheshi "Willson", ku lëvizja do të devijohet në drejtim të rrugës "Sami Frashëri", pak para përfundimit të ndeshjes. Ndërkohë, Rruga e Elbasanit, Unaza dhe bulevardi "Bajram Curri" do të jenë të lira për qarkullimin e mjeteve.

Policia njofton gjithashtu se tifozët do t'i nënshtrohen kontrolleve të imtësishme para hyrjes në stadium. Në ambientet e stadiumit nuk do të lejohet futja e banderolave me përmbajtje raciste, fishekzjarrëve, flakadanëve, lëndëve piroteknike, monedhave metalike, çadrave, çakmakëve, karikuesve të celularëve dhe sendeve të tjera të forta apo të rrezikshme.

Njoftimi i policisë:

Policia e Shtetit/Plan masash për garantimin e rendit dhe sigurisë, para, gjatë dhe pas zhvillimit të ndeshjes së futbollit ndërmjet ekipeve të Shqipërisë dhe Bjellorusisë, që do të zhvillohet mbrëmjen e sotme, në orën 20:45, në stadiumin "Air Albania".

Plani i masave parashikon detyrat që do të kryejnë të gjitha strukturat, duke u mbështetur në përvojën pozitive për planifikimin, organizimin dhe menaxhimin e situatës së rendit dhe sigurisë publike gjatë aktiviteteve ndërkombëtare.

Për mbarëvajtjen e këtij aktiviteti, si dhe për të lehtësuar qarkullimin e automjeteve në qytetin e Tiranës, gjatë datës 26.09.2026, nga ora 17:00 deri në përfundim të ndeshjes, nga Policia e Shtetit, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake të Tiranës, do të aplikohen kufizime të qarkullimit të mjeteve në disa akse rrugore në afërsi të stadiumit.

Rrugët që do të jenë të bllokuara nga ora 17:00 deri në përfundim të ndeshjes:

-Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nga fast food-i "Laguna", pranë urës së ish-Hotel Dajtit;

-Rruga "Papa Gjon Pali II", te kryqëzimi i RTSH-së;

-Rruga "Dervish Hima", pranë Ambasadës së SHBA-së;

-Rruga "Asim Zeneli", pranë Ambasadës së SHBA-së;

-Rruga "Themistokli Gërmenji", në hyrje;

-Rruga "Ismail Qemali", te kryqëzimi i RTSH-së;

-Rruga "Lekë Dukagjini", pranë ish-Gardës së Republikës (koridor hyrjeje për në parkimin e caktuar, vetëm për mjetet e autorizuara nga FSHF-ja);

-Rruga "Abdyl Frashëri", pranë kryqëzimit të Librit Universitar;

-Te sheshi "Willson", devijohet lëvizja në drejtim të rrugës "Sami Frashëri", pak para përfundimit të ndeshjes.

Rruga e Elbasanit, Unaza dhe bulevardi "Bajram Curri" do të jenë të lira për lëvizjen e mjeteve.

Në zbatim të planit të masave, punonjësit e Policisë së Shtetit do të ushtrojnë kontroll të imtësishëm ndaj tifozëve, para futjes në stadium, me qëllim parandalimin e futjes në stadium të banderolave me përmbajtje raciste, të fishekzjarrëve, flakadanëve, lëndëve piroteknike, monedhave metalike, çadrave, çakmakëve, karikuesve të celularëve, mjeteve/produkteve për përdorim kozmetik dhe sendeve të tjera të forta, të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e pjesëmarrësve.

Kërkojmë mirëkuptimin e tifozëve që të paraqiten në hyrjen e stadiumit, duke filluar nga ora 18:30, pasi, për shkak të fluksit të tifozëve, pak para fillimit të ndeshjes mund të humbasin mundësinë për të hyrë në stadium.




**Gysi, Bela, Lali, Klodi si maska të një njeriu të vetëm**




Kthesa e fortë/ Euro fiton terren ndaj Lekut brenda javës




Qeveria lëviz emrat: Kush ikën dhe kush vjen




Zbardhen debatet në gjyq të "shokëve" të Ergys Agasit/ "Pse Vlora Hysenin s'e mbani në burg?"

Për mbarëvajtjen e këtij aktiviteti sportiv, Policia e Shtetit ka angazhuar qindra punonjës policie, të cilët do të garantojnë rendin dhe sigurinë publike, si dhe do t'iu ofrojnë ndihmë dhe informacion, në rast nevoje, në mënyrë që ky aktivitet të përmbyllet pa incidente, në interes të imazhit të vendit.


## Të këshilluara



### Industria e veshjeve e këpucëve po kalon krizën më të thellë në historinë e tranzicionit

Për të katërtin vit radhazi, industria e prodhimit të këpucëve po humbet terren. Ky segment, ku veprojnë disa nga sipër...



### Të shtëna me armë zjarri në një lokal në Athinë/ Plagoset 10-vjeçarja shqiptare, gjendet i djegur mjeti i autorëve

Të shtëna me armë zjarri ka ndodhur pak pas mesnatës në zonën e Agios Panteleimonas në Athinë, ku mbeti e plagosur nj&e...



### Eldi Dizdari do të ekstradohet nga Dubai në Belgjikë



### Mali i Zi ndalon ngarkesën me mish të skaduar të destinuar për Kosovën, sekuestrohen 24 tonë të shpërndara në 1300 pako

Dogana e Malit të Zi njoftoi më 25 shtator se ka ndaluar në Portin e Tivarit një kontejner me mish të ngrirë gjedhi me afat...



### Kushtetuesja në Bosnje ndalon financimin për lobim lidhur me shkëputjen e Republikës Sërpska

Gjykata Kushtetuese e Bosnje e Hercegovinës vendosi të premten t'i ndalojë pagesat nga buxheti i Republikës Sërpska për lob...



### Nga aleatë të SHBA-së në të pandehur: Pse Uashingtoni e mbështeti Gjykatën Speciale për Kosovën

Nga Fron Nahzi Shpallja fajtor më 16 shtator i katër ish-udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe d&eu...



## Aksident i rëndë në Fushë Krujë/ Humb jetën 19-vjeçari, plagosen 2 të tjerë



### Rrjeti i Agasit/ Mes tenderëve të AKSHI-t, pengmarrjes së Meçes dhe sekreteve të SHISH

Nga komunikimet e Vlora Hysenit me Ergys Agasin, te pengmarrja e Gerond Meçes: emrat, episodet dhe fijet që bashkojnë biznesin, policinë dhe institucionet e sigurisë së shtetit shqiptar



### Pamje të rënda/ Autori i vrasjes së "Tanit të Ruzhdiut" në Sarandë kishte 2 armë në dorë

Me skafandër dhe dy armë në duar. Kështu është shfaqur autori i vrasjes së Artan Murtajt në Sarandë pak ditë ...



### Detajet/ Kush e priti dhe kë do takojë ambasadori i ri i SHBA në Tiranë

Mbërriti në Shqipëri mesditën e kësaj të premteje, (25/9) ambasadori i ri i SHBA-ve në vendin tonë. Ish-gjenerali Eri...

# Me sytë katër



21:35

### "Më shau, e shava"/ Shefi i komisariatit të Krujës flet pas pamjeve të shpullës

Një situatë e paprecedentë raportohet të ketë ndodhur një muaj më parë në qytetin e Durrësit, ku shefi i Komis...



PAMJET/ Protestuesit kapin Bledi Çuçin në kafe, bashkëshortja e tij Delina Fico humb durimin

23:13



VIDEO/ Muriqi feston me bluzën e UÇK-së golin ndaj Irlandës

22:44



Kryemadhi: Si nuk i fiku njeri radarët për



PAMJET VIRALE/ Presidenti i Haitit pi ujë




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.